

AUTORITETI I ÇERTIFIKIMIT
KONTABILITETI, RAPORTIMI FINANCIAR DHE ANALIZA E PASQYRAVE
FINANCIARE
2015

Teza me përgjigje

PYETJE ME ALTERNATIVA (CDO PYETJE VLERESOHET ME NJE PIKE)

1. Zërat në të ardhurat e tjera gjithë përfshirëse paraqiten të analizuar:

- a. Sipas natyrës.
- b. Sipas funksionit.
- c. Ose sipas natyrës ose sipas funksionit (një zgjedhje e politikës kontabël).
- d. (a) dhe (b) mësipër

Përgjigja e saktë: alternativa (a)

2. Një njësi ekonomike ka blerë një markë tregtare për një produkt konsumi kryesor. Marka tregtare ka një jetë ligjore të mbetur prej pesë vitesh, por është e rinovueshme çdo dhjetë vjet me një kosto të ulët. Njësia ekonomike synon ta rinovojë markën tregtare vazhdimisht. Si rezultat i një analize që ka bërë për (i) ciklin e jetës së produktit, (ii) tendencat e tregut, dhe (iii) mundësitë e zgjerimit të markë, njësia ka siguruar evidencën e nevojshme se produkti i markës tregtare do t'i gjenerojë flukse monetare neto për një periudhë të pacaktuar. Jeta e dobishme e aktivitetit afatgjatë jo-material është:

- a. pesë vjet - periudha fillestare e të drejtave kontraktuale.
- b. supozohet të jetë 10 vjet - nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së tij të dobishme.
- c. 15 vjet - periudha fillestare e të drejtave kontraktuale plus një periudhë rinovimi.
- d. pesë vjet - periudha e të drejtave kontraktuale, por pa njohur shpenzimet e amortizimit, meqë aktivi pritet të gjenerojë flukse monetare për një periudhë të pacaktuar.

Përgjigja e saktë: alternativa (b)

3. Aktivet për tatime të shtyra janë:

- a. Shuma të tatimeve mbi fitim të rikuperueshëm, që lindin nga krijimi i diferencave të përkohshme të tatueshme të zbritshme.
- b. Shuma të tatimeve mbi fitimin të pagueshme në periudha të ardhshme dhe që lindin nga krijimi i diferencave të përkohshme të tatueshme
- c. Shuma totale të përfshirë në përcaktimin e fitimit apo humbjes neto për periudhën në lidhje me tatimin e periudhës dhe detyrimin tatimor të shtyrë.
- d. asnjë prej tyre

Përgjigja e saktë: alternativa (a)

4. Një investitor duhet të klasifikojë investimet në pjesëmarrje si:

- a. aktive afatshkurtra;
- b. aktive afatgjata;
- c. detyrime afatshkurtra;
- d. kapitali i vet.

Përgjigja e saktë: alternativa (b)

5. Rreziku i likuiditetit është:

- a. Rreziku që një njësi ekonomike nuk do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me pasivet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvritimit të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar
- b. Rreziku që një njësi ekonomike do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me pasivet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvritimit të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar
- c. Rreziku që një njësi ekonomike nuk do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me pasivet financiare që nuk duhet të shlyhen nëpërmjet lëvritimit të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar
- d. Rreziku që një njësi ekonomike do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me pasivet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvritimit të mjeteve monetare ose një pasivi tjetër financiar

Përgjigja e saktë: alternativa (b)

6. Një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar nëse, dhe vetëm nëse, ose:

- i) transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivitetit financiar, ose
 - ii) ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivitetit financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual t'u paguajë flukset monetare një ose më shumë marrësve në një marrëveshje.
- a. i
 - b. i – ii
 - c. ii
 - d. asnjëra

Përgjigja e saktë: alternativa (b)

7. Monedha funksionale është:

- a. Monedha e Eurozonës për të gjithë vendet e BE-së dhe ato vende që kanë statusin e kandidatit për në BE.
- b. Monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin një shoqëri operon.
- c. Monedha funksionale në të gjithë botën është Dollari Amerikan.
- d. Monedha funksionale në Shqipëri është gjithmonë Leku.

Përgjigja e saktë: alternativa (b)

8. Supozoni se nga magazina tërhiqen 20 000 lekë lëndë e parë për tu hedhur në prodhim. Nga kjo sasi, 15 000 lekë janë materiale direkte dhe 5 000 lekë janë materiale indirekte. Cilat llogari do të debitohen për këtë veprim?

- a. “Prodhimi në proces” me 15 000 lekë dhe “Materiale” me 5 000 lekë
- b. “Materiale” me 15 000 lekë dhe “Shpenzime të përgjithshme të prodhimit” me 5 000 lekë
- c. “Shpenzime të përgjithshme të prodhimit” me 15 000 lekë dhe “Prodhimi në proces” me 5 000 lekë
- d. “Prodhimi në proces” me 15 000 lekë dhe “Shpenzime të përgjithshme të prodhimit” me 5 000 lekë

Përgjigja e saktë: alternativa (d)

9. Cili nga percaktimet e mëposhtme është i pasaktë lidhur me heqjen e mandatit të anetarit të Keshillit Kombëtar të Kontabilitetit para përfundimit të tij:

- a. Behet i paafte për shkak sëmundjeje
- b. Kryen një veprim penale
- c. Shkon me pushime të gjata
- d. Nuk përmbush kërkesat e caktuara në Rregulloren e Brendshme të KKK.

Përgjigja e saktë: alternativa (c)

10. Pagat e kompanise u rriten per 2.000.000 leke dhe u arketuan 10.000.000 leke llogari te arketueshme. Cili nga te meposhtmet e pershkruan me mire efektin e ketyre dy transaksioneve?

- a. E ardhura neto do te rritet
- b. Raporti korrent (AASH/DASH) do te pakesohet.
- c. Flukset nga aktivitetet operative do te pakesohen.
- d. Asnje nga te mesipermet.

Përgjigja e saktë: alternativa (b)

I. KUADRI I ZBATUESHEM I RAPORTIMIT FINANCIAR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

1. Çfare sugjerohet mbi krahasueshmerine e te dhenave te pasqyrave financiare dhe si duhet bere klasifikimi i elementeve ne pasqyrat financiare? (2 pike)

Përgjigja:

1. PF duhet t'u japin mundesi perdoruesve qe te bejne krahasime ndermjet ushtrimeve te ndryshme kontabel ose njesive te ndryshme ekonomike. **(1 pikë)**
2. Paraqitja dhe klasifikimi i elementeve behen me koherence nga njeri ushtrim kontabel ne tjetrin, pervec rastit kur ndryshimi kerkohe nga nje standard i ri kontabel ose kur ndryshimi çon ne nje paraqitje me te pershtateshme te ngjarjeve ose transaksioneve ne PF te njesise ekonomike. **(1 pikë)**

V.o. PF- Pasqyrat Financiare

2. Shpjegoni periudhen e ruajtjes se dokumentacionit kontabel. (2 pike)

Përgjigja:

Regjistrat kontabel dhe evidencat mbeshetese ruhen per 10 vjet pas mbylljes se vitit ushtrimor kontabel, te cilit i perkasin pervec atyre qe me ligj ose akt tjeter nenligjor, percaktohet nje afat me i gjate ruajtjeje. **(1.5 pikë)**

I njejti afat zbatohet edhe per dokumentat informatike (bartesit) dhe printimet e tyre. **(0.5 pikë)**

STANDARDET KOMBETARE TE KONTABILITETIT

1. Për secilin nga zërat e mëposhtëm tregoni pozicionin në pasqyrën e pozicionit financiar duke shpjeguar arsyet: **(5 PIKE)**

- Aktive biologjike të mbajtur për riprodhim
- Një provizion për shitje automjetesh me garanci 2-vjeçare
- Një pasiv tatimor i shtyrë
- Një hua e dhënë me afat 5 vjet por huadhënësit i lind e drejta të kërkojë shlyerjen brenda vitit të ardhshëm për shkak të shkeljes së kontratës
- inventaret

Përgjigja:

- Aktive biologjike të mbajtur për riprodhim	Aktivitet biologjike të mbajtura për riprodhim pozicionohen në bilanc si aktive afatgjata brenda kategorise aktive biologjike sikurse është ilustruar në pasqyrën e pozicionit financiar ilustrative të dhëna në SKK 2. Këto lloje aktivesh priten të japin përfitime për më shumë se një periudhë në dallim me aktive të ngjashme, si kafshet e mbajtura për majmeri, të cilat do të klasifikoheshin si afatshkurtra. (1 pikë)
- Një provizion për shitje automjetesh me garanci 2-vjeçare	Perllogaritja e provizionit do të ofronte informacionin me të mirë nëse do të këto nevojë që vlerën e provizionit ta ndajmë mes pjesës afatshkurter dhe afatgjate duke treguar si afatgjate vetëm ato kosto reklamimi/riparimi që perllogariten të ndodhin pas më shumë se 1 vit nga data e raportimit. Mund të jepet 0.5 pike për afatshkurter dhe 0.5 për afatgjate.
- Një pasiv tatimor i shtyrë	Gjithmone afatgjate sipas kërkesave për paraqitje të SKK 2. (1 pikë)
- Një hua e dhënë me afat 5 vjet por huadhënësit i lind e drejta të kërkojë shlyerjen brenda vitit të ardhshëm për shkak të shkeljes së kontratës	Afatshkurter – pavarësisht afatit 5 vjeçar huaja është e kerkueshme brenda vitit në vijim pas datës së raportimit për shkak të shkeljes së kushteve të kontratës. (1 pikë)
- inventaret	Afatshkurter pasi pritet të shndërrohet brenda ciklit normal operacional të njesise. (1 pikë)

2. Mbi çfarë bazash behet dallimi ne bilanc mes zërave afatshkurtër dhe afatgjatë. Përkufizoni aktivet afatshkurtra dhe afatgjata. (4 PIKE)

Përgjigja:

Një njësi ekonomike do të paraqesë aktivet afatshkurtra dhe afatgjata, detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata, si klasifikime të veçanta në pasqyrën e pozicionit financiar, përveç kur një prezantim në bazë të likuiditetit siguron informacion që është i besueshëm dhe më shumë i përshtatshëm. Në zgjedhjen e një formati të pasqyrës së pozicionit financiar, të ndryshëm nga ai i përshkruar në shtojcën 1 të Standardit, një njësi ekonomike mund ta quajë me vend mosklasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve të saj si afatgjata dhe afatshkurtra (për shembull, në rastin e institucioneve financiare ku në përputhje me praktikën ndërkombëtare nuk bëhen dallime të tilla në pasqyrën e pozicionit financiar). Në këtë rast, njësi ekonomike duhet t'i paraqesë aktivet dhe detyrimet e saj në pasqyrën e pozicionit financiar sipas kriterit të likuiditetit. (1 pike per permendjen e mundesise per perjashtim dhe bazes se likuiditetit)

Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: (a) ajo pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (1 pike) (b) ajo e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi; (1 pike) (c) ajo pret të realizojë aktivin brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) aktivi është mjet monetar ose një ekuivalent i mjeteve monetare, nëse nuk është i kufizuar për t'u përdorur për shkëmbim ose të përdoret për të shlyer një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. (1 pike)

3. Një njësi ekonomike merr me qira një makineri përgjatë tërë jetës ekonomike të kësaj të fundit nga një shoqëri leasing (lizingu). Aktivi do të çregjistrohet në fund të periudhës së leasing-ut nga shoqëria leasing. Pronësia ligjore e aktivit i mbetet shoqërisë leasing përgjatë afatit të qirasë. Cili do të jetë klasifikimi për këtë makineri nga ana e qiramarrësit? Argumento përgjigjen. (4 PIKE)

Përgjigja:

Paragrafi 18 i SKK 1, thekson faktin se është kontrolli (përparësia e thelbit mbi formën) dhe jo pronësia e një zëri ekonomik që përcakton nëse ai mund ose nuk mund të njihet si një aktiv. (1 pike) Makineria do të trajtohet si një aktiv nga qiramarrësi dhe jo qiradhënësi. (1 pike) Kjo për shkak se ekzistenca (afati) e qirasë i jep qiramarrësit të drejtën e përdorimit të aktivit gjatë gjithë jetës së tij të dobishme. Për këtë arsye, makineria do të përfshihet si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar të qiramarrësit. Me shume detaje ne lidhje me kete teme jepen ne SKK 7 – Kontabilizimi i qirave në dhe seksionin Udhëzuesi për zbatimSKK 7 – Kontabilizimi i qirave në dhe seksionin Udhëzuesi për zbatim. (2 pike).

4. Më 1 janar 2012 firma ABC ka blerë një makinë sipas termave në vijim: (5 PIKE)

Çmimi bazë i prodhuesit	1 050 000 lekë
Zbritje tregtare (zbatuar vetëm mbi çmimin bazë)	20%
Skonto e përfituar për shlyerje para kohe (mbi shumën e pagueshme vetëm sipas koston bazë)	5%
Shpenzime transporti	30 000 lekë
Kostoja e instalimit elektrik	28 000 lekë
Trainimi i stafit për përdorimin e makinës	40 000 lekë
Testimi para prodhimit	22 000 lekë
Lidhja e një kontrate mirëmbajtjeje trevjeçare	60 000 lekë
Vlera e mbetur e vlerësuar	20 000 lekë
Jeta e dobishme në orë e makinës	6 000 orë
Orët e shfrytëzimit –	
- për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012	1 200
- për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2013	1 800
- për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014 (shih më poshtë)	850

Më 1 janar 2014 firma vendosi ta përmirësojë makinën duke i shtuar një komponent të ri me një kosto 200 000 lekë. Ky përmirësim do të çojë në uljen e kohës së prodhimit për njësi të produkteve që prodhohen duke përdorur këtë makinë. Gjithashtu, përmirësimi do të rrisë jetën e mbetur të vlerësuar të makinës më 1 janar 2014 në 4 500 orë dhe vlera e mbetur është rishikuar dhe vlerësuar të jetë 40 000 lekë.

Kërkohet:

- Përgatisni ekstraktet nga pasqyra e performancës dhe pasqyra e pozicionit financiar për makinën për secilin nga tre vitet deri më 31 dhjetor 2014.

Zgjidhja:**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR¹**

	31.12.2012	31.12.2013	31.12.2014
	<i>(në lekë)</i>	<i>(në lekë)</i>	<i>(në lekë)</i>
Aktive afatgjata materiale (shih llogaritjet 1)	740 000	470 000	551 000
Vlerësimi në pikë (me llogaritje)	1pikë	0.5 pikë	0.5pikë

PASQYRA E PERFORMANCËS

Për vitin deri më	31.12.2012	31.12.2013	31.12.2014
	<i>(në lekë)</i>	<i>(në lekë)</i>	<i>(në lekë)</i>
Amortizimi (shih llogaritjet 2)	180 000	270 000	119 000
Mirëmbajtja (60 000 /3 vjet)	20 000	20 000	20 000
Skontoja për pagesën (840 000 x 5%)	(42 000)		
Shpenzime trainimi	<u>40 000</u>		
	198 000	290 000	139 000
Vlerësimi në pikë (me llogaritjet)	1pikë	0.5 pikë	1.5 pikë

*Llogaritjet:***1. Llogaritja e kostos fillestare së AAM**

Çmimi i faturuar (bazë)	1 050 000
Minus Skonto tregtare (20%)	<u>(210 000)</u>
Kosto bazë	840 000
Shpenzime transporti	30 000
Kostoja e instalimit elektrik	28 000
Testimi para prodhimit	<u>22 000</u>
Kosto fillestare	920 000

2. Llogaritja e amortizimit

Amortizimi për orë = (920 000 – 20 000) / 6000 orë	150 lekë/orë
Viti 2012 : 150 x 1200 orë	180 000
Viti 2013 : 150 x 1800 orë	270 000
Viti 2014:	
Vlera kontabël më 1 janar 2014 = 920 000 – (180 000 + 270 000)	470 000
Shpenzimet e mëpasshme	<u>200 000</u>
Kosto e rishikuar	670 000
Amortizimi i rishikuar: (670 000 – 40 000) / 4500 orë = 630 000 / 4500	140 lekë/orë
Amortizimi 2014 : 140 x 850 orë	119 000

¹*Shënim:* Pasqyra e pozicionit financiar mund të jetë paraqitur dhe në këtë formë nga pjesëmarrësi në provim:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	31.12.2012	31.12.2013	31.12.2014
	(në lekë)	(në lekë)	(në lekë)
Aktive afatgjata materiale (shih llogaritjet 1)	920 000	920 000	670 000
Amortizimi i akumuluar	<u>(180 000)</u>	<u>(450 000)</u>	<u>(119 000)</u>
Vlera kontabël neto	740 000	470 000	551 000
Vlerësimi në pikë (me llogaritje)	1pikë	0.5 pikë	0.5pikë

Tabela e vlerësimit për ushtrimin 4

Pasqyra e pozicionit financiar	Pikët
Viti 2012	1.0
Viti 2013	0.5
Viti 2014	0.5
Pasqyra e performancës	
Viti 2012	1.0
Viti 2013	0.5
Viti 2014	<u>1.5</u>
Totali	5.0

5. Në vijim jepet një pjesë e informacionit të marrë nga pasqyra e pozicionit financiar dhe shënimet shpjeguese të një shoqërie që merret me prodhimin e ujit mineral natyral: (5 PIKE)

AKTIVET		
Aktive afatgjata materiale		
Ndërtesat – me kosto	3 900	
- Amortizimi i akumuluar më 1 janar 2014	<u>(1 100)</u>	2 800
Makineri dhe pajisje – me kosto	7 000	
- Amortizimi i akumuluar më 1 janar 2014	<u>(3 400)</u>	3 600
Mjete transporti – me kosto	2 240	
- Amortizimi i akumuluar më 1 janar 2014	<u>(840)</u>	<u>1 400</u>
		7 800

Informacion shtesë:

1. Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare dhe ngarkohet si vijon:

Ndërtesat	- 2% në vit	–	në shpenzimet administrative
Makineri e pajisje	- 20% në vit	-	në koston e mallrave të shitura

Gjatë 2013, firma ka shitur disa zëra të makinerive dhe pajisjeve që janë përdorur në prodhimin e ujit mineral natyral për 600 000 lekë. Këto makineri dhe pajisje kanë patur një kosto fillestare 2 000 000 lekë dhe një vlerë kontabël për 1 000 000 lekë. Në librat kontabël është bërë regjistrimi në debi të mjeteve monetare dhe në kredi të koston së produkteve të shitura i të ardhurave nga shitja e makinerive. Sipas politikës së shoqërisë amortizimi ngarkohet për një vit të plotë në vitin e blerjes dhe në vitin e shitjes nuk regjistrohet.

2. Shoqëria i ka amortizuar mjetet e transportit për 8 vite. Në 2013, për shkak të kilometrazhit vjetor të rritur, drejtoria vendosi t'i amortizojë për 5 vjet. Amortizimi i mjeteve të transportit iu ngarkohet kostove të shpërndarjes.

Kërkohet:

1. Të llogaritet amortizimi për periudhën.
2. Cili është trajtimi kontabël sipas SKK 5 kur bëhet ndryshimi i metodës së amortizimit ?

Zgjidhja:

1. Llogaritja e amortizimit për periudhën

	Kostoja	Amortizimi	PASH – Formati 2 (sipas funksionit)	
Ndërtesat	000 lekë	000 lekë		
	3 900	1 100		
Amortizimi (2%)		78	Shp. administrative	0.5 pikë
	3 900	1 178		
Makineri dhe pajisje	7 000	3 400		
Nxjerrja jashtë përdorimit ¹	(2 000)	(1 000)		
	5 000	2 400		
Amortizimi (20%)		1 000	Kosto e mallrave të shitura	1.5 pikë
		3 400		
Mjetet e transportit ²	2 240	840		
		700	Shp. të shpërndarjes	1.5 pikë
		1 540		

¹Meqë artikulli kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa makinerive dhe pajisjeve në 2013 është i gabuar, korrigojnë vlerat në çelje për 2014.

Artikulli i nxjerrjes jashtë përdorimit të makinerive: (nuk futet në vlerësim)

Mjete monetare	600 000	
Amortizim i akumuluar	1 000 000	
Humbje nga nxjerrja j.p.	400 000	
Te		2 000 000
Makineri&pajisje		

² Deri në 1 janar 2014 është akumuluar amortizimi i 3 viteve (2240 /8 x 3 vjet) = 840.

Pra, për 2014 amortizimi = 1 400 000 / 2vjet = 700 000 lekë (d.m.th. mbeten 2 vjet nga 5 vjet, pas rishikimit)

2. Njësia ekonomike do ta trajtojë ndryshimin në **metodën e amortizimit** si një ndryshim në një vlerësim kontabël në përputhje me SKK 1 *Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*. Ndryshimet në vlerësimet kontabël do të njihen gjatë periudhës kontabël kur ato kanë ndodhur, dhe jo në retrospektivë. **1.5 pikë**

Tabela e vlerësimit për ushtrimin 5

Pyetja 1	Pikët
Amortizimi i ndërtesave	0.5
Amortizimi i makinerive	1.5
Amortizimi i mjeteve transportit	1.5
Pyetja 2	<u>1.5</u>
Totali	5.0

6. Më 31dhjetor 2014, inventari i njësisë ekonomike u numërua dhe u vlerësua me kosto prej 1 milion lekë. Disa artikuj të inventarit me një kosto 210 000 lekë ishin dëmtuar gjatë një përmbyetjeje të ndodhur më 15dhjetor 2014 dhe nuk mund të shiteshin me çmimin e tyre normal i llogaritur duke përfshirë një marzh fitimi bruto prej 30%. Shitja e këtyre mallrave do të realizohej nëpërmjet një agjenti shitjeje, i cili do t'i shiste me 80% të çmimit normal të shitjes dhe do të mbante një komision shitjeje prej 25%. **(4 PIKE)**

Kërkohet:

1. Me çfarë vlere do të raportohet inventari në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014?
Cili do të ishte efekti në pasqyrën e performancës për vitin 2014?

Zgjidhja:

Kërkesa e SKK 4 (i përmirësuar) për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur e detyron njësinë ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh (rasti kur disa produkte dëmtohen përpara se të shiten (paragrafi 24)).

Efekti në pasqyrën e performancës:

Humbja nga zhvlerësimi 30 000 lekë **1.0 pikë**

Llogaritjet :

Çmimi normal i shitjes së inventarit të dëmtuar: 210 000 / 70%	300 000	0.5 pikë
Çmimi i vlerësuar i shitjes (ÇVSH) : 300 000 x 80%	240 000	0.5 pikë
ÇVSH – kosto e shitjes: 240 000 – (240 000 x 25%)	180 000	1.0 pikë
Humbja nga zhvlerësimi : 210 000 – 180 000	30 000	

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar:

Vlera e inventarit 970 000 (1 mil – 30 000) **1.0 pikë**

Në shënimet shpjeguese paraqitet vlera kontabël dhe shuma e zhvlerësimit.

Tabela e vlerësimit për ushtrimin 6

Pasqyra e pozicionit financiar	Pikët
Vlera e inventarit	1.0
Pasqyra e performancës	
Humbja nga zhvlerësimi	1.0
Çmimi normal i shitjes së inventarit të dëmtuar	0.5
Çmimi i vlerësuar i shitjes (ÇVSH)	0.5
ÇVSH – kosto e shitjes	<u>1.0</u>
Totali	4.0

7. Një shoqëri qiradhënëse kishte në pronësi një aktiv. Gjatë periudhës 2018 deri 2014 ajo e ka dhënë me qira financiare sipas kontratave të mëposhtme: (4 PIKE)

1. Për shoqërinë A për vitet 2008 dhe 2009, qiraja vjetore është 1,000,000 Lekë
2. Për shoqërinë B për vitet 2010, 2011 dhe 2012, qiraja vjetore është 800,000 Lekë. Shoqëria A është shoqëri e kontrolluar nga shoqëria B
3. Për shoqërinë C për vitet 2013 dhe 2014, qiraja vjetore është 500,000 Lekë. Shoqëria C nuk është palë e lidhur me shoqërinë A ose B.
Vlera e mbetur e aktivit në fund të vitit 2014 përlllogaritet në shumën 600,000 Lekë, dhe asnjë nga qiramarrësit nuk ka garantuar blerjen e aktivit në fund të afatit të qirasë.

Kërkohet: Përcaktoni se cilat nga pagesat e mësipërme duhet të përfshihen në llogaritjen e:

- Pagesave minimale të qiramarrësve
- Pagesave minimale të qiradhënësit
- Në Llogaritjen e normës së interesit të nënkuptuar në qira

Zgjidhja:

a) Pagesat minimale të qiramarrësve **(1 pike)**

Shoqëria A dhe B janë pale të lidhura

Për shoqëritë A dhe B $2 * 1,000,000 + 3 * 800,000 = 4,400,000$ Lekë

Shoqëria C $2 * 500,000 = 1,000,000$ Lekë

b) Pagesat minimale të qiradhënësit **(1 pike)**

Në rastin e qiradhënësit si pagesa minimale do të jenë të gjitha totalitetet e qirave të paguara nga qiramarrësit.

Pra: $4,400,000 + 1,000,000 = 5,400,000$ Lekë

c) Në llogaritjen e normës së interesit të nënkuptuar në qira do të merren parasysh: **(2 pike)**

Arkëtimet minimale të qiradhënësit + vlerën e mbetur të paguarantuar =

$5,400,000 + 600,000 = 6,000,000$ Lekë

8. Me qëllim shtimin e punësimit të personelit të saj shoqëria tregtare AGM ka përfituar një grant në shumën 4 milion leke. Disa muaj më vonë ajo denohet me një gjore prej 1 milion leke për demtim të mjedisit, pasi mbetjet kimike të prodhimit të saj i ka hedhur në lumë. Shuma e gjores është e pazbritshme për qëllime tatimore. Supozojmë se tatimi mbi fitimin është 15%, fitimi kontabel është 486 milion leke dhe në këtë shumë është përfshirë edhe granti edhe gjora. **(4 PIKE)**

Kërkohet: Të përcaktohen diferencat e përhershme dhe të llogaritet fitimi kontabel i shoqërisë AGM

Zgjidhja:

Edhe pse si granti ashtu sikurse edhe gjora janë reflektuar në pasqyrat financiare (fitimin kontabel), ato nuk do të përfshihen në llogaritjen e tatimit, pra ato do të konsiderohen diferencat të përhershme (2 pike)

Fitimi kontabel	486,000,000	
Minus Grantin	- 4,000,000	
Plus Gjora	<u>+ 1,000,000</u>	
Fitimi i tatueshem	483,000,000	
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (15%)	72,450,000	(2 pike)

(konsiderohet përgjigje e saktë që shuma e grantit të përfituar të jetë diferencë e përkohshme ose nuk përbën as diferencë të përkohshme as diferencë të përhershme)

(Pa vlerësim)	
Shpenzimi tatim fitimi	72,450,000
Tatimi mbi fitimin i llogaritur	72,450,000

Regjistrohet shpenzimi i tatimit mbi te ardhurat per periudhen kontabel

9. Njësia A është paditur në një çështje gjyqësore për shkelje të të drejtave të patentës. Avokatët e shoqërisë kanë vlerësuar që ka një mundësi prej 30% që gjykata të mbyllë çështjen dhe njësia të mos jetë e detyruar të paguajë asgjë. Megjithatë nëse gjykata vendos në favor të paditësit, ka 20% shanse që njësia do të duhet të paguajë një shumë prej 200 mijë lekë (shuma që kërkohet nga paditësi) dhe një mundësi prej 80% që njësisë ti kërkohet të paguajë 100 mijë lekë (shumë e kërkuar në raste të ngjashme). Parashikohet që nuk ka mundësi dalje të tjera. Gjyqi mendohet të përfundojë më dhjetor 2011. Nuk ka evidencë që paditësi do të heqë dorë nga padia. **(5 PIKE)**

Kërkohet: A duhet të krijohet njësia A provizion për konfliktet gjyqësore në fund të vitit 2009? Nëse po cila është ngjarja detyruese dhe sa është vlera e provizionit

Zgjidhja:

Krijohen kushte për të njohur një Provizion pasi

1. Ekziston një ngjarje detyruese, çështja gjyqësore, e cila ka ndodhur para datës së raportimit; (1 pike)
2. është e mundshme që njësia ekonomike të përballojë shpenzime, në lidhje me zgjidhjen e çështjes gjyqësore; mundësitë e humbjes së gjyqit janë më të medha (70%) se sa ato të fitimit të tij (30%) (1 pike)
3. shuma e shpenzimeve të pritshme, që lidhen me çështjen gjyqësore, mund të vlerësohet relativisht me saktësi. Vlera e provizionit do të jetë $(20\% * 200,000 + 80\% * 100,000) = 120,000$ lekë sepse alternativa me vlerën më të madhe ka mundësinë më të vogël (2.5 pike)

Regjistrimi në ditar: (0.5 pike)

6.... Shpenzime për gjyq	120,0000
Te	
4631... Provizione për çështje gjyqësore	120,000

(pa vlerësim)

Meqenëse konflikti gjyqësor pritet të përfundojë pas 2 vjetësh nga data e krijimit të provizionit, vlera e detyrimit duhet të aktualizohet me normën e interesit 2-vjecar të obligacioneve shtetërore e korrigjuar me riskun

10. Njësitë ekonomike A dhe B (dy njësi ekonomike pa lidhje me njëra tjetrën) zotërojnë secila 50 përqind të aksioneve të zakonshme që mbartin të drejta votuese në mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve të njësisë ekonomike Z. Vendimet strategjike në njësinë ekonomike Z kërkojnë miratim nga investitorët që zotërojnë një shumicë të thjeshtë (d.m.th më shumë se 50 përqind) të fuqisë votuese. **(3 pikë)**

Kërkohet:

- Cila nga njësitë e kontrollon njësinë ekonomike Z.

Përgjigja:

Me kusht që njësitë ekonomike A dhe B të kenë lidhur një marrëveshje kontraktuale që përcakton kontrollin e tyre të përbashkët mbi njësinë ekonomike Z, ajo është një sipërmarrje e përbashkët (njësi ekonomike e kontrolluar bashkërisht). Njësitë ekonomike A dhe B duhet t'i njohin investimet e tyre në njësinë ekonomike Z si investime në pjesëmarrje të përbashkët

11. Një kontraktor ndërtimi lidh një kontratë me çmim fiks prej 100,000 lekë për të ndërtuar një ndërtesë sipas një projektimi që nuk është bërë kurrë më parë dhe duke përdorur materiale që nuk janë përdorur asnjëherë më parë për ndërtimin e një ndërtese (projekti). Kontraktori e filloi ndërtimin e ndërtesës në vitin 2014 dhe pret që ndërtimi të zgjasë të paktën pesë vjet. Në vitin 2014 kontraktori pati 5,000 lekë kosto kontrate për këtë projekt. Në fund të vitit 2014 kontraktori nuk mund ta vlerësojë rezultatin e kontratës me besueshmëri të mjaftueshme për vlerësimin e përqindjes së përfundimit të projektit (p.sh. për shkak të pasigurive që rrjedhin nga projektimi i ri dhe materialet e reja njësia ekonomike nuk mund t'i vlerësojë kostot totale të pritshme të kontratës me besueshmëri të mjaftueshme). Me shumë gjasa çmimi i kontratës do të merret nga klienti. **(4 pikë)**

Kërkohet: Tregoni trajtimin kontabël për njohjen dhe vlerësimin e te ardhurave.

Përgjigja:

Ref. SKK8 p32: Kur rezultati i një kontrate shërbimi apo ndërtimi nuk mund të vlerësohet me besueshmëri, (a) një njësi ekonomike duhet të njohë të ardhura deri në masën e kostove të kryera të cilat mund të rikuperohen.

(b) njësia duhet të njohë kostot e kontratës si shpenzim i periudhës kur ato janë kryer.

Si rrjedhim, shoqëria do të njohë të ardhura në shumën 5,000 lekë dhe në të njëjtën masë do të njohë shpenzime në pasqyrën e performancës të vitit.

12.Një njësi ekonomike shet ushqim për kafshët dhe ka 100 klientë. Dorëzimi i mallit bëhet ditën e fundit të çdo muaji. Afatet standarde të pagesës kërkojnë që pagesa të bëhet brenda 45 ditësh pas dorëzimit të mallit. Sipas politikës së ndjekur nga njësi ekonomike, klientëve që paguajnë brenda 15 ditëve pas dorëzimit të mallit u ofrohet një skonto prej 2% për pagesë të shpejtë. Përvoja ka treguar që 45% e klientëve zakonisht paguajnë brenda 15 ditëve dhe 55% e tyre paguajnë pas 15 ditësh. Njësi ekonomike dorëzon tek klientët e saj një parti ushqimesh më 31 janar 2013. Çmimi total i shitjeve të faturuara për të gjitha dërgesat arrin shumën 1,000 lekë. **(4 pikë)**

Kërkohet: Si do t'i trajtojë njësi ekonomike skontot për pagesë të parakohshme në datën e shitjes?

Zgjidhja:

Ref. SKK8 p8, p10, p16, Njësi ekonomike do të njohë të ardhura në masën që është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri (p8). Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë (p9), prandaj skontot për pagesë të shpejtë do të konsiderohen në vlerësimin e të ardhurave: Gjithashtu, të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: **(pa vlerësim)**

(a) njësi ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; (b) njësi ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; (c)shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; (d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësi ekonomike; (e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Si rrjedhim, në datën 31 janar 2013, njësi ekonomike do të njohë të ardhurat duke qene se plotësohen kushtet për njohjen e të ardhurave nga shitja e mallrave. Shuma e të ardhurave të njohura do të matet duke u bazuar në vlerën e drejtë të arkëtueshme, duke marrë parasysh zbritjet tregtare që do të aplikohen sipas eksperiencës së mëparshme:

$$\text{Matja e të ardhurave: } 1,000 \times (1-0.02)*45\% + 1,000 \times 55\% = 991$$

Regjistrimi kontabël:

D	Llogari të arkëtueshme	1,000	
K	Të ardhura nga shitja		991
K	Shuma të parashikuara për mosarkëtim nga skontot		9

Pas 15 ditësh nga shitja (momenti i njohjes së të ardhurave) do të bëhet rregullimi i shumës së parashikuar nga mosarkëtimi. Diferenca midis shumës së parashikuar dhe vlerës reale të skontos do të korrigjojë shumën e të ardhurave nga shitja

13.Një donator ka vënë në dispozicion shumën prej 120,000 Euro në formën e grantit që do të përdoret për të subvencionuar kurse trajnimi për policinë bashkiake të Tiranës. Kjo shumë e grantit do të përdoret për të mbuluar 50% të kostove gjithsej të kurseve të trajnimit që kualifikohen për këtë lloj granti. Në periudhën aktuale është realizuar 40% e trajnimit dhe kosto që është shpenzuar për të llogaritet në 46,000 Euro. **(5 pikë)**

Kërkohet: Kur duhet të njihet granti dhe si do të paraqiten regjistrimet.

Zgjidhja:

Sipas SKK10 p9 (b) grantet që imponojnë kushte specifike, njihen kur plotësohen kushtet. Sipas SKK10 p13, të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me grantin njihen në pasqyrën e performancës në zërin të ardhura të tjera të shfrytëzimit (ose shpenzime) ose si zë me vete. Në këtë rast, shpenzimi i njohur për trajnimet do të reduktohet me 50% që është granti që shërben për rimbursim të tyre (ose shpenzimet dhe të ardhurat nga granti do të njihen veçmas pa u kompensuar). **(2 pikë)**

Fillimisht granti është regjistruar:

D Banka	120,000	
K Të ardhura të shtyra	120,000	(1 pikë)

Në fund të vitit:

D Shpenzime trajnimi	46,000	
K Detyrime/të tjera	46,000	(1 pikë)

D Të ardhura të shtyra	23,000	
K Të ardhura nga granti (shp.trajnimi)	23,000	(1 pikë)

NJOHURI PER STANDARDET NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR

- 1.** Njësia ekonomike A zotëron 45% të aksioneve me të drejtë vote të njësisë ekonomike B dhe gjithashtu ka të drejtë të emërojë pjesën më të madhe të bordit drejtues. **(3 pikë)**

Kërkohet:

Cila është marrëdhënia midis njësive ekonomike A dhe B

Përgjigja:

Njësia A e kontrollon njësinë B. Fakti që emëron pjesën më të madhe të anëtarëve të Bordit Drejtues do të thotë se ka fuqinë të qeverisë politikat financiare dhe operative të njësisë B. Në këtë rast njësia A e kontrollon njësinë B edhe pse ka më pak se gjysmën e të drejtave të votave.

- 2.** Në vitin 2009, filiali i shoqërisë mëmë (M) bëhet një adoptues për herë të parë i SNRF-ve, ndërsa shoqëria mëmë (M) bëhet adoptues për herë të parë i SNRF-ve në vitin 2010. **(3 pikë)**

Kërkohet:

Me cilën vlerë do të mbahen aktivet dhe detyrimet e filialit për qëllime të konsolidimit në vitin 2010?

Përgjigja:

Për të hartuar PF të konsoliduara, shoqëria mëmë (M) do të përdorë të njëjtat vlera kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve që përdor filiali (në 2010), me përjashtim të korigjimeve të konsolidimit

- 3.** Shoqëria tregtare A blen një grup biznesi për shumën 55 milion lekë. Ajo parashikon që një pjesë të këtij grupi ta shesë, me supozimin që nuk do të ketë kosto për këtë shitje. Le të supozojmë se vlera e drejtë e kësaj pjese që shitet minus kostot e shitjes është 8 milion lekë. Për pjesën tjetër të mbetur të biznesit, aktivet vlejné 50 milion lekë, detyrimet 11 milion lekë dhe detyrimet e kushtëzuara vlejné 2 milion lekë. **(3 pikë)**

Kërkohet:

- Cila është kosto e kombinimit të biznesit.
- Paraqesni skematikisht regjistrimin.
- Sa do të jetë vlera e emrit të mirë në këtë rast?

Përgjigja:

Nga të dhënat e mësipërme del se shoqëria A ka paguar për të blerë grupin e bizneseve një shumë 10 milion lekë më të madhe se vlera e drejtë e aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara të grupit të bizneseve, pasi aktivet neto llogariten në 45 milion lekë në kohën kur shuma e paguar është 55 milion lekë. Pjesa e biznesit që mbahet për shitje vlerësohet me vlerën e drejtë të shitjes minus kostot e shitjes

- Kosto e kombinimit të biznesit është vlera e drejtë e aktiveve të dhëna plus kostot e transaksionit, pra shuma e paguar 55 milionë lekë. **0.5 pikë**
- Regjistrimi: **2 pikë**

	Debi	Kredi
Emri i Mirë	10 m	
Aktivet – të ndryshme	50 m	
Banka		55 m
Detyrimet - të ndryshme		11 m
Detyrimet e Kushtëzuara		2 m
Aktivet “e mbajtura për shitje”	8 m	
<i>Blerja e biznesit dhe shpërndarja e kostove</i>		

- Vlera e emrit të mirë do të jetë diferenca midis kostos së kombinimit dhe vlerës së drejtë të aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara të grupit të bizneseve të blera, pra vlera 10 milionë lekë. **0.5 pikë**

KONTABILITETI I KOSTOS DHE I DREJTIMIT

1. Reparti i montimit në shoqërinë Sahati sh.p.k përdor sistemin e kostos së prodhimit të vazhdueshëm, me metodën FIFO për të llogaritur koston e produktit të vetëm që prodhon, ora muri. Ajo ka vetëm një repart prodhimi, atë të montimit të orave. Për muajin prill 2015, jepen të dhënat si më poshtë: **(4 pikë)**

	Njësi fizike	Materiale direkte	Kosto përpunimi
Prodhimi në proces në fillim	80	493 360 lekë	91 040 lekë
Shkalla e përfundimit: 90 % për materialet direkte; 40 % për kostot e përpunimit			
Kosto të shtuara gjatë periudhës		3 220 000 lekë	1 392 000 lekë
Njësi të filluara gjatë periudhës	500		
Prodhimi në proces në fund	120		
Shkalla e përfundimit: 60 % për materialet direkte; 30 % për kostot e përpunimit			

Kërkohet:

- a. Paraqitni rrjedhën e njësive fizike në repartin e montimit të shoqërisë Sahati gjatë muajit prill 2015.
- b. Llogarisni njësitë ekuivalente në repartin e montimit, për muajin prill 2015 për çdo kategori të kostove të prodhimit.

Zgjidhja:

Rjedha e njësive fizike në repartin e montimit të kësaj shoqërie gjatë muajit prill 2015, dhe llogaritja e njësive ekuivalente për çdo zë të kostove të prodhimit do të ishte si më poshtë (kolona e parë e tabelës rrjedha e njësive fizike dhe në dy kolonat e fundit njësitë ekuivalente):

- *për çdo llogaritje të saktë të njësive fizike, nga 0,25 pikë; në total për njësitë fizike 1 pikë (pra, pa marrë parasysh si pjesë të zgjidhjes të dhënat e ushtrimit, njësi prodhim proces në fillim dhe njësitë e filluara gjatë periudhës)*
- *për çdo vlerë të njësive ekuivalente të llogaritur saktë nga 0,5 pikë; kjo kërkesë në total 3 pikë për gjashhtë llogaritjet e njësive ekuivalente)*

Rrjedha e njësive fizike:	Njësi fizike		
Njësi prodhim në proces në fillim	80		
plus: Njësi të filluara gjatë periudhës	500		
baras: Njësi totale fizike	580		
		Njësi ekuivalente	

Njësi produkti të përfunduara nga:		Materialet direkte	Kostot e përpunimit
• Prodhimi në proces në fillim	80	8 (= 80 * 10%)*	48 (= 80 * 60%)
• Njësi të filluara gjatë periudhës	380	380	380
plus: Njësi prodhimi në proces në fund	120	72 (= 120 * 60%)	36 (= 120 * 30%)
baras: Njësi totale	580	460	464

* Për llogaritjen e njësisve ekuivalente për kategoritë e kostove veprimet mund të bëhen ose në tabelën e mësipërme ose detajet mund të shpjegohen vecmas jashtë tabelës.

2. Sistemi i kostos së shoqërisë Sidenor sh.a, ka identifikuar pesë qendra aktiviteteve për shpenzimet e përgjithshme të prodhimit: prokurimet, lëvizja e materialeve, mirëmbajtja e makinerive, inspektimi i produkteve dhe paketimi. Më poshtë jepen të dhëna në lidhje me shpenzimet e përgjithshme të buxhetuara dhe faktorët e kostos së buxhetuar për çdo qendër aktiviteti. (5 pikë)

<i>Qendra e aktivitetit</i>	<i>Shpenzimet e përgjithshme të buxhetuara</i>	<i>Faktori i kostos</i>	<i>Niveli i buxhetuar i faktorit të kostos</i>
Prokurimet	35 000 lekë	Numri i urdhrave të blerjeve	2 000
Lëvizja e materialeve	43 750 lekë	Numri i lëvizjeve	5 000
Mirëmbajtja e makinerive	118 650 lekë	Orët e makinerive	10 500
Inspektimi i produkteve	9 450 lekë	Numri i inspektimeve	1 200
Paketimi	19 950 lekë	Njësi të prodhuara	3 800

Shoqëria është në proces të përgatitjes së ofertave për dy tendera: për një shkollë dhe për një muze. Të dhënat për faktorët e kostove të nevojshme për përbushjen e secilës porosi jepen në vijim.

Shkolla

Muzeu

Numri i urdhrave të blerjeve	25	8
Numri i lëvizjeve të materialeve	10	4
Orët e makinerive	40	60
Numri i inspektimeve të kryera	9	3
Njësi të prodhuara	15	6

Kërkohet:

- a. Llogarisni shumën totale të shpenzimeve të përgjithshme që do të llogaritet për secilën prej ofertave (për shkollën dhe muzeun) sipas një metode kostoje tradicionale në të cilën shpërndarja e shpenzimeve të përgjithshme bëhet në bazë të numrit të orëve të makinerive.
- b. Llogarisni shumën totale të shpenzimeve të përgjithshme që do të llogaritet për secilën prej ofertave (për shkollën dhe muzeun) sipas metodës së kostos së bazuar në aktivitet.

Zgjidhja:

- a. Llogaritja e SHPP totale me metodën tradicionale për cdo ofertë **(1,5 pikë në total)**.

Me metodën tradicionale shpenzimet e përgjithshme do të llogariten dhe do të shpërndahen në bazë të orëve të makinerive. Shuma e shpenzimeve të përgjithshme është 226 800 lekë (shuma e shpenzimeve të përgjithshme për të gjitha qendrat e kostove). Kurse orët e makinerive na janë dhënë 10 500. Llogarisim koeficientin e shpërndarjes (llogaritjes) të shpenzimeve të përgjithshme si më poshtë: **(0,5 pikë llogaritja e koeficientit)**

$$\text{Koeficienti i shpenzimeve të përgjithshme} = \text{SHPP} / \text{Orë makineri}$$

$$\text{Koeficienti} = 226\,800 \text{ lekë} \div 10\,500 \text{ orë makineri} = 21,6 \text{ lekë për një orë makineri.}$$

Më poshtë shpenzimet e përgjithshme të llogaritura për cdo porosi me formulën:

$$\text{SHPP të llogaritura} = \text{Koeficienti} \times \text{Orë makineri për secilën ofertë}$$

	<u>Shkolla</u>	<u>Muzeu</u>
SHPP të llogaritura	<u>864 lekë^a</u>	<u>1 296 lekë^b</u>

$$^a 21,6 \text{ lekë për orë makineri} \times 40 \text{ orë} = 864 \text{ lekë}$$

0,5 pikë

$$^b 21,6 \text{ lekë për orë makineri} \times 60 \text{ orë} = 1\,296 \text{ lekë}$$

0,5 pikë

- b. Llogaritja e SHPP totale me metodën ABC **(3,5 pikë në total)**

Së pari llogarisim koeficientin e shpenzimeve të përgjithshme për cdo qendër aktiviteti si raport të shpenzimeve të përgjithshme të asaj qendre dhe faktorit përkatës të kostos: **(llogaritja e koeficientëve të saktë vlerësohet me 1,5 pikë në total, nga 0,30 pikë për cdo koeficient)**

<i>Qendra e aktivitetit</i>	<i>SHPP të buxhetuara</i>	<i>Faktori i koston</i>	<i>Niveli i buxhetuar i faktorit të koston</i>	Koeficienti për cdo qendër aktiviteti (SHPP / Faktori i koston) *
Prokurimet	35 000 lekë	Numri i urdhrave të blerjeve	2 000	17,5 lekë për një urdhër blerje
Lëvizja e materialeve	43 750 lekë	Numri i lëvizjeve	5 000	8,75 lekë për një lëvizje
Mirëmbajtja e makinerive	118 650 lekë	Orët e makinerive	10 500	11,3 lekë për një orë makineri
Inspektimi i produkteve	9 450 lekë	Numri i inspektimeve	1 200	7,875 lekë për një inspektim
Paketimi	19 950 lekë	Njësi të prodhuara	3 800	5,25 lekë për një njësi të prodhuar
	<u>226 800</u>			

* Llogaritja e koeficientëve mund të bëhet edhe jo në formë tabele por si zbatim i formulës; do të konsiderohet edhe ashtu e saktë, mjafton koeficienti të jetë llogaritur sa duhet.

Më pas llogarisim shpenzimet e përgjithshme për cdo ofertë si më poshtë: (2 pikë në total; nga 1 pikë për cdo kolonë llogaritjesh më poshtë; ose 0,4 pikë për cdo rresht llogaritjesh).

	Shkolla	Muzeu
SHPP të llogaritura		
Prokurimet (17,5 × 25; 8 urdhra)	437,5	140
Lëvizja e materialeve (8,75 × 10; 4 lëvizje)	87,5	35
Mirëmbajtja e makinerive (11,3 × 40; 60 orë makineri)	452	678
Inspektimi i produkteve (7,875 × 9; 3 inspektime)	70,88	23,63
Paketimi (5,25 × 15; 6 njësi)	<u>78,75</u>	<u>31,5</u>
Totali	<u>1 126,63</u>	<u>908,13</u>

*Llogaritjet mund të mos bëhen në formë tabele por si zbatim direkt i formulës: SHPP të llogaritura = koeficient x faktori i koston. Do të konsiderohet edhe ashtu e saktë.

ANALIZA E PASQYRAVE FINANCIARE

1. Per shoqerite D dhe E kemi keto te dhena mbi aktivet e detyrimet afatshkurtera te saj per vitin 2014:

	Shoqeria D	Shoqeria E
Aktivet afatashkurtra	400.000	900.000
Detyrimet afatshkurtra	200.000	700.000
Kapitali punues	200.000	200.000

Kerkohet:

1. Vleresoni shkallen e likuiditetit te dy shoqerive duke llogaritur perqindjen e mjaftueshmerise se kapitalit punues (Raporti Kapital punues/AASH). (2 pike)

2. Komentoni cila prej tyre gjendet ne situatë me te mire te likuiditetit dhe cila eshte me ne veshtiresi. (2 pike)

Zgjidhja:

1.

	Shoqeria D	Shoqeria E
1. Aktivet afatashkurtra (AASH)	400.000	900.000
2. Detyrimet afatshkurtra	<u>200.000</u>	<u>700.000</u>
3. Kapitali punues (1-2)	200.000	200.000
4. % e Mjaftueshmerise se Kapitalit Punues = Kapitali Punues / AASH * 100	$200 / 400 \times 100 = 50\%$	$200 / 900 \times 100 = 22.2\%$

2. Duke gjykuar mbi % e Mjaftueshmerise se Kapitalit Punues duket sikur Shoqeria D me % me te larte te ketij treguesi, konkretisht 50%, eshte ne situatë me te mire likuiditeti se Shoqeria E, e cila rezulton me % e mjaftueshmerise se kapitalit punues 22.2 %.

Megjithate, duhet theksuar se para se analisti te konkludoje per likuiditetin e te dy shoqerive duhet te gjykoje mbi cilesine e aktiveve afatshkurtra te ketyre dy njesive ekonomike.

Pra, nese kane me shume likuiditete apo kane llogari te arketueshme e inventare, te cilat (LLA e Inventaret) duan me shume kohe te kthehen ne likuiditete.

Pra, treguesi i perqindjes mjaftueshmerise se kapitalit nuk duhet te jete as shume i larte si ne rastin e shoqerise D, por as shume i ulet (jo nen 20%). Nisur nga ky kusht, duket ne situatë me te pranueshme shoqeria E.

2. Firma AA i raporton informacionin e mëposhtëm bankës ku po aplikon për kredi. Juve ju kërkohet të vlerësoni kapacitetin e borxhit (huamarrës) të shoqërisë AA. Për industrinë ku kjo operon raporti mesatar “borxh / kapital aksioner” arrin vlerën 100%.

	2014	2013	2012
Raporti i mbulimit të kostove fikse	4.00	2.50	1.54
Raporti i mbulimit të interesave	4.94	3.17	2.08
Raporti i borxhit total ndaj aktiveve totale	0.47	0.51	0.56
Borxhi ndaj aktiveve neto të prekshme	0.91	1.06	1.36

Kërkohet:

- Llogarisni raportin “borxh / kapital aksioner” për vitet 2012 - 2014, duke u bazuar në raportin borxh / aktive totale. (3 pike)
- Komentoni kapacitetin e borxhit (huamarrës) të kësaj firme. (2 pike).

Zgjidhja:

a)

	2014	2013	2012
1.Kapitali aksioner = Totali Aktiveve - Borxhi total= Viti '14 = 100 - 47 = 53; '13 = 100 - 51 = 49; '12 = 100 - 56 = 44	53	49	44
2.Raporti i borxhit total ndaj Kapitalit aksioner Viti '14 = 47 / 53 = 0.88; 51/49 =1.04; 56/44 = 1.27	0.88	1.04	1.27

b) Raporti borxh / capital aksioner karakterizohet nga permiresim nga nje vit ne tjetrin nga 1.27 here ne 2012 ne 1.04 here ne vitin 2013 e me tej ne 0.88 here ne 2014. Duket qe raporti **vjen duke u permiresuar nga viti ne vit**. Pra, ne keto kushte **rritet besueshmeria e kreditoreve** tek njesia ekonomike.

Kete konstatim lidhur me permiresimin e treguesit borxh ndaj kapitalit aksioner e konfirmojme edhe duke pare raportin e mbulimit te kostove fikse, i cili vjen duke u rritur nga 1.54 deri ne 4 here, pra eshte rritur aftesia e fitimit per te mbuluar kostot fikse. Po keshtu, duke pare raportin e mbulimit te interesave, i cili nga 2.08 here arrin ne 4.94 here, konstatojme nje permiresim te raportit te mbulimit te shpenzimeve te interesit nga Fitimi para interesave e tatim taksave.

Edhe raporti Borxh / aktiveve neto te prekshme eshte permiresuar. Nga 1.36 here ne vitin '12 arrin ne 0.91 here. Me kete nenkuptojme se (per vitin '14), cdo lek AAGJ neto e mbulojme me 0.91 lek borxh, pjesen tjetere 0.09 leke e mbulojme me kapital. Ndersa, ne vitin '12 te gjitha AAG neto jane mbuluar me borxh dhe ne kete rast risku eshte me i larte dhe besueshmeria e kreditoreve me e ulet.

Ne teresi mund te themi se kapaciteti **i borxhit te kesaj firme eshte ne permiresim** nga viti 2012 ne vitin 2014.